

## **Analiza vjetore 2022, për Departamentin e Njësive të Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore**

Më datën 17 Shkurt 2023 në ambientet e Kontrollit të Lartë të Shtetit në Tiranë u zhvillua analiza vjetore e Departamentit të Njësive të Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore (DANJVQV), e cila u fokusua në prezantimin e rezultateve të Departamentit për vitin 2022, problematikat e shfaqura, si dhe sfidat e për të ardhmen.

Të pranishëm në këtë analizë ishte z. Kristaq Gjurgjaj, Auditues i Lartë në Drejtorinë e Kontrollit të Cilësisë dhe Zbatimit të Standardeve.

Takimi u hap nga Drejtori i Departamentit z. Bledar Doracaj, i cili evidentoi rezultatet e arritura nga Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, por edhe mangësitë e konstatuara, me qëllim përmirësimin e tyre përgjatë vitit 2023.



Më pas, Kryeaudituesi i Sektorit të Auditimit Njësive të Vetëqeverisjes Vendore Z. Berti Meçaj paraqiti raportin mbi veprimtarinë e Sektorit të Auditimit Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të nivelit të I-rë dhe të II-të, për vitin 2022, në të cilin përveç rezultateve të auditimeve apo sfidave për të ardhmen.

Për vitin 2022 janë realizuar 72 auditime për pushtetit vendor, nga të cilat 9 subjekte janë audituar 2 herë, pasi për periudhën e auditimit nuk ishin mbyllur pasqyrat financiare të vitit 2021, 25 janë auditime financiare, 35 janë auditime financiare dhe përputhshmërie, 2 auditime të zbatimit të rekomandimeve si dhe 1 auditim tematik.

Për vitin 2022 kanë filluar auditimin në terren 10 subjekte nga të cilat; 5 subjekte janë në fazë raporti përfundimtar, 3 subjekte janë në fazë projekt raporti dhe në 2 subjekte nuk është mbyllur faza e terrenit.

Për përmirësimin e gjendjes së subjekteve të audituara janë lënë gjithsej, 1,298 masa organizative, 190 masa për shpërblim dëmi në vlerën prej 285,122 mijë lekë, 458 masa për efekte negative në menaxhimin me economicitet, efience dhe efektivitet në shpenzime, në vlerën prej 6,694,426 mijë lekë si dhe janë evidentuar të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkive në vlerën prej 22,236,132 mijë lekë. Gjithashtu, në vijimi të përpjekjeve për të ndryshuar klimën e mos ndëshkueshmërisë, janë rekomanduar masa disiplinore dhe administrative për ndëshkimin e personave të cilësuar përgjegjës në raportet tona të auditimit duke rekomanduar 76 masa administrative dhe 223 masa disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil”.



Më pas, Kryeaudituesi i Sektori të Auditimit të Menaxhimit të Aseteve z. Luan Kuka paraqiti raportin mbi “Objektivat e veprimtarisë audituese, faktorët e riskut, fenomenet kryesore të konstatuara sipas fushave si dhe masat e rekomanduara”. Për vitin 2022 janë planifikuar dhe realizuar 17 auditime, prej të cilave 10 i përkasin auditimeve të llojit përputhshmërie në fushën e kadastrës, 5 auditime të kombinuara në fushën e mjedisit dhe 2 auditime janë për zbatim rekomandimesh. Nga 10 auditime të fushës së kadastrës, 2 auditime janë në proces evadimi. Veprimtaria jonë si sektor përqendrohet kryesisht jo vetëm në auditimin e procesit të miratimit të akteve të fitimit të pronësisë, administrimit të tyre dhe regjistrimit fillestar të pronës, kjo në dy shtyllat kryesore të këtij procesi, në ish-ALUIZNI dhe atë ish-ZVRPP, aktualisht të shkruara në ASHK. Veprimtaria audituese është shtrirë për periudhën e fundit paraardhëse dhe kryesisht në vitet 2019-2021.

Për përmirësimin e gjendjes së subjekteve të audituara janë lënë gjithsej, 2 masa për përmirësime ligjore, 231 masa organizative, 31 masa për efekte negative në menaxhimin me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet në administrimin e pronës publike, në vlerën prej 48,201 mijë lekë. Gjithashtu, në vijimi të përpjekjeve për të ndryshuar klimën e mos ndëshkueshmërisë, janë rekomanduar 121 masa disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Parajllajmërim për zgjidhje të kontratës së punës”.

Në analizë pjesëmarrësit ndoqën e diskutuan mbi prezantimet:

- Mbi auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Selenicë përgatitur nga z. Genci Koka
- Mbi auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Korçë përgatitur nga z. Përparim Gjuzi
- Mbi auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Skrapar përgatitur nga z. Shkënder Muça
- Problemet makro të kadastrës, përmirësim/përditësimet të pronave përgatitur nga z. Redi Ametllari